



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:076057

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06633628

2024:123399

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykyese Fitore Daci me zyrtaren ligjore Egzona Livoreka, në çështjen penale kundër të pandehurit J.I, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 paragrafi 1, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II.Nr.211/24, të datës 26.04.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të dëmtuarit R.S si dhe përfaqësuesit të tije Av.Visar Musa, të pandehurit J.I dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av.Arbnor Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më datë 18.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 20.12.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

J.I, i lindur më, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, nga i ati I..... dhe nëna S....., e gjinisë S....., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 01.02.2024, rreth orës 22:00, në fshatin, Komuna Ferizaj, saktësisht në tek villat “.....”, më dashje dhe duke përdor forcën fizike dhe e ka sulmuar të dëmtuarin R.S, në atë mënyrë që me tu takuar tek vendi i punës së të dëmtuarit, pas një mosmarrëveshje verbale, fillimisht i pandehuri del nga vetura e tij dhe fillon ta godas me grushte në fytyrë të dëmtuarin, pastaj e shtynë dhe i dëmtuari rrëzohet në tokë, por prapë i pandehuri vazhdon ta godas të njëjtin, ndërsa aty ka ndërhyrë personi A.I duke e ka larguar të pandehurin.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 184, paragrafi 1, të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 184 paragrafi 1 të KPRK-së dhe neneve 364, 462, të KPPK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim konform nenit 44, të KPPK-së, si dhe me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 1.000€ (një mijë euro), të cilin dënim është i obliguar të e paguaj në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 43 paragrafi 3, të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do të i shndërrohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro, të pandehurit do të i llogaritet një ditë burgim.

I dëmtuari R.S me vendbanim në fshatin -Komuna Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzetë euro), në emër të ekspertizës mjeko – ligjore të datës të paguajë shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data kur Aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.Nr.211/24, të datës 26.04.2024, e ka ngarkuar të pandehurin J.I, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184, paragrafi 1, të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.06.2024, ku i pandehuri në këtë shqyrtim ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza.

Brenda afatit të paraparë ligjor avokati mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur kërkesës për hüdhen e aktakuzës dhe kundërshtimit të provave, në bazë të kësaj kërkesë gjykata ka nxjerr Aktvendimin e datës 19.07.2024.

Brenda afatit të paraparë ligjor mbrojtësi i të pandehurit ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit të datës 19.07.2024. Gjykata e Apelit ka nxjerr Aktvendimin e datës 22.08.2024 më të cilin Aktvendim është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të pandehurit, ndërsa është vërtetuar Aktvendimi i datës 19.07.2024.

Pas pranimi të vendimit nga Gjykata e Apelit të Kosovës, gjykata caktoi seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 18.12.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, i dëmtuari R.S, me përfaqësuesin e tij me autorizim Av.Visar Musa, si dhe i pandehuri J.I me mbrojtësin e tij me autorizim Av.Arbnor Hasani.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.12.2024, pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 241 paragrafi 1, të KPPK-së dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit.

Pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 241 paragrafi 4, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri J.I., me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka theksuar se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza, si dhe i vjen keq që ka ndodhur kjo vepër penale.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, Gjyqtaria e vetme gjykuese në kuptim të nenit 242 paragrafi 5, të KPPK-së, ka kërkuar që Prokurori i Shtetit dhe i dëmtuari me përfaqësuesin e tij të jap mendimet e tyre lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase ky pranim i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 322 lidhur me nenin 242, të KPRK-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, prandaj gjykatës i propozon që këtë pranim fajësie të e aprovoj.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit R.S, Av.Visar Musa, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, për faktin se konsideron se është e domosdoshme nxjerrja e një ekspertize mjekësore që të konstatohet natyra e lëndimeve trupore për të dëmtuarin ngase konsideron se mund të kemi edhe një vepër tjetër penale dhe atë veprën të lëndimit të lehtë trupor.

I dëmtuari R.S., duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e përkrah mendimin e përfaqësuesi të tij dhe diçka tjetër nuk ka për të shtuar.

Mbrojtësi i te pandehurit J.I, Av.Arbnor Hasani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit deklaron: e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij pasi që konsideron se ky pranim është në përputhje me gjendjen faktike dhe me aktin akuzues të paraqitur nga prokuroria. Ky pranim i fajësisë është bërë nga i mbrojturi i tij pas konsultimeve të mjaftueshme me të si mbrojtës duke sqaruar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj kërkon nga gjykata që ta aprovojë pranimin e fajësisë.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 322 paragrafi 2, të KPPK-së, edhe përkundër paralajmërimit të të pandehurit

për nenin 246 paragrafi 1, të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si: raporti i Oficerit i datës, deklarata e dëshmitarit SH.S të dhënë në polici me datë, deklarata e dëshmitarit A.I, dhënë në polici me datë, deklarata e të dëmtuarit R.S, dhënë në polici me datë, deklarata e të pandehurit të dhënë në polici me datë, Raporti mjekësor që i datës, Raporti mjekësor i Spitalit të përgjithshëm-Qendra Emergjente në Ferizaj, me numër protokollit, i datës, Raporti mjekësor i Spitalit të përgjithshëm-Qendra Emergjente në Ferizaj, me numër protokollit, i datës, Ekspertiza mjeko-ligjore e datës, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë, dhe konstatoi se Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjyqtarja e vetme gjyqëse konform nenit 322 lidhur me nenin 242 paragrafi 4, të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit Ismet Rrahmani në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: pas seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit, konsideron se ky pranim është mbështetur duke pasur për bazë edhe shkresat e lëndës që i'u janë bashkëngjitur aktakuzës, sidomos raporti mjekësor i datës dhe ekspertiza mjeko- ligjore të datës, andaj duke pasur për bazë të gjitha shkresat që i'u janë bashkëngjitur aktit akuzues i propozon gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti shqiptojë një sanksion penal të paraparë me ligj. Sa i përket rrethanave gjykata të ketë parasysh si ato lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, e po ashtu gjykata të ketë parasysh rrethanat rënduese, mënyrën e kryerjes të veprës penale, shkallën e dashjes nga ana e të pandehurit për kryerjen e kësaj veprë penale si dhe intensitetit dhe dëmtimin e vlerës së mbrojtur – njeriut.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit R.S, Av.Visar Musa në fjalën përfundimtare deklaron, pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit i propozon gjykatës që të merr parasysh veçanërisht rrethanat rëndësuese me rastin e shqiptimit të dënimit duke pasur parasysh faktin se si ka kryer veprën penale i akuzuari e cila i ka paraprirë disa mosmarrëveshjeve të mëparshme me të afërmit e tjerë të familjes, pastaj mënyrën se si e godit dhe shkon e sulmon në vendin e punës të dëmtuarin të cilin e ka edhe dajë, rrethanën që pasi e godet dhe e rrëzon në tokë fillon ta godas edhe me tutje derisa ka qenë i rrëzuar i dëmtuari po ashtu i propozon gjykatës të merr parasysh edhe raportet mjekësore dhe ti shqiptoj një dënim që të jetë preventiv që në të ardhmen mos të përsërisë çfarëdo veprimi në drejtim të të dëmtuarit. Po ashtu i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe do të paraqesin kërkesë pasurore – juridike.

I dëmtuari R.S në fjalën përfundimtare deklaron: nuk ka diçka tjetër për të shtuar përpos që e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të tij.

Mbrojtësi i të pandehurit J.I, Av. Arbnor Hasani në fjalën përfundimtare deklaron: meqenëse i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë për veprën penale që e ngarkon aktakuza konsideron se gjykata gjatë matjes së dënimit të këtë parasysh veçanërisht rrethanat lehtësuese, siç janë, pranimi i fajësisë, pendimi i thellë nga i pandehuri për rastin e ndodhur, po ashtu si rrethanë lehtësuese gjykata të merr edhe faktin se i njëjti asnjëherë nuk ka pasur të kaluar kriminale, i njëjti po ashtu jeton edhe jashtë vendit dhe meqenëse edhe prindi i tij jeton jashtë vendit dhe ka gjendje të rënduar shëndetësore i njëjti vazhdimisht shkon jashtë vendit dhe tash e tutje është në procedurë të rregullimit të dokumentacionit në shtetin e Zvicrës me qëllim që të jetoj atje për të krijuar familje, dhe kërkon që këtë fakt gjykata ta merr parasysh në dënimin e shqiptuar. Ndërsa sa i përket rrethanave rëndësuese konsideron se në rastin konkret nuk ka pasur asnjë rrethanë rënduese sepse ditën kritike i njëjti nuk ka shkuar me qëllimin që të përleshet me të dëmtuarin. Konsideron se rrethanat rënduese të përmendura nga pala e dëmtuar nuk kanë ekzistuar asnjëherë sepse nuk ka qenë qëllimi ose dashja e të akzuarit që të vije deri tek përleshja ashtu siç ka ndodh.

Andaj, duke i pasur parasysh këto rrethana veçanërisht rrethanat lehtësuese i propozon gjykatës që ndaj të pandehurit të shqiptoj një dënim me gjobë duke konsideruar se ky dënim është i mjaftueshëm dhe e plotëson qëllimin e dënimit që i njëjti të mos kryej vepra të ngjashme penale në të ardhmen.

I pandehuri J.I në fjalën përfundimtare deklaron: e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit të tij mbrojtës, edhe njëherë kërkon falje për gjithë atë çka ka ndodh se për çka ka ndodhur kjo çështje ai deklaron se ka pasur një arsye, ndihet shumë keq që ka ndodhur ky rast dhe i propozon gjykatës që mundësisht të i shqiptojë një dënim me gjobë, dhe nëse eventualisht gjykata vendos që ndaj tij të shqipton dënim me burgim, jep pëlqimin që dënimi të zëvendësohet me gjobë pasi që pas konsultimeve me mbrojtësi e tij konsideron se plotësohen kushtet të shqiptohet një dënim i tillë. Shton se personalisht pas ditës kritike ka dërguar njerëz të vullnetit të mirë tek familja e të dëmtuarit por të njëjtit nuk e kanë pranuar kërkimin faljen.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurit

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, Sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që i pandehuri me datë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më dashje dhe duke përdor forcën e ka sulmuar të dëmtuarin ku pas një mosmarrëveshje verbale, fillimisht i pandehuri ka dalur nga dhe ka filluar ta godas me grushte të dëmtuarin, pastaj e shtyen dhe i dëmtuari rrëzohet në tokë, por prap i pandehuri vazhdon ta godas të njëjtin, derisa aty ndërhyjnë personi A.I.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimin gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, të KPRK-së, dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit që në fillim të seancës së shqyrtimit gjyqësor, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori parasysh faktin se i pandehuri është përdorur për veprën e kryer penale dhe ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsëris, kërkimin faljen publike nga ana e të pandehurit, faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, pra është i pa dënuar më parë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh raportin familjar që ka i pandehuri me të dëmtuarin, pra janë nip dhe dajë, andaj vendosi që të pandehurit të i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimin të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Kërkesa pasurore juridike

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është marr në kuptim të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2, të KPPRK-së.

Shpenzimet procedurale

Vendimi mbi shpenzimet paushalle dhe atë të procedurës është marr në kuptim të nenit 452 paragrafi 1, lidhur me nenin 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6, të KPPRK-së.

Vendimin për kompensimin nga Fondi për Kompensimit të viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit 08/L-109.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
2024:123399, datë 20.12.2024

Zyrtare ligjore
Egzona Livoreka

Gjyqtarja
Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.